



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria – Vlada - Government*

**Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health**  
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë, 13.03.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores për Prokurim Publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës **08.03.2023**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik **Sinorg Pharmaceuticals**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Furnizim me Barna për DSHB”** me Nr. të Prok: **206-23-657-1-2-1** nxjerr:

**V E N D I M**

1. **Refuzohet** kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik Sinorg Pharmaceuticalstë dt. 08.03.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me Barna për DSHB”, me nr. të Prokurimit: **206-23-657-1-2-1**, kundër Njoftimit për Kontrate të Autoritetit Kontraktues të datës 09.02.2023 të publikuar në platformën elektronike.
2. **Vërtetohet** Njoftimit për Kontrate i datës 09.02.2023;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

**A r s y e t i m**

Operatori Ekonomik Sinorg Pharmaceuticals me datë 08.03.2023 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me Barna për DSHB”, me nr. të prokurimit: 206-23-657-1-2-1. Autoriteti Kontraktues, me datë 13.02.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

**Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues sipas OE Sinorg Pharmaceuticals:**

**Neni 1 – Qellimi**

**Neni 6 – Ekonomiciteti dhe Efikasiteti**

**Neni 7 – Barazia në trajtim / jo-Diskriminim**

**Neni 56 - Dispozitat e Pergjithshme mbi Perzgjedhjen e Pjesemarrësve dhe Dhenien e Kontratave**

### **Pretendimi ankimor**

Kompania jone " Sinorg Pharmaceuticals" pas analizimit dosjes se tenderit "Furnizim me barna për DSHB" me numër te prokurimit: 206-23-657-121 si pale e pakënaqur kërkojmë ri-shqyrtimin e vendimit te AK për publikimin e kësaj procedure.

Ne konsiderojmë se është bere shkelje e Neneve - 1,6,7,56 duke u bazuar se Ministria e Shëndetësisë është ne proces te nënshkrimit te kontratës se njëjte, me te njëjtit artikuj dhe saktësisht për Furnizim me barna për DSHB – shih: **Furnizim me Barna dhe Pajisje te imëta Mjekësore për DSHB / 206 – 22- 3716 – 111 LOT 1, kjo e mbështetur edhe me vendimin e OSHP nr. 425/22, ku ne tani jemi dita – e – ditës duke pritur nënshkrimin e kontratës.**

Ne baze te "Ligji për Prokurimin Publik te Republikës se Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068 dhe Ligjin Nr.05/L-092" nuk lejohet iniciimi i dy procedurave te njëjta te prokurimit ne te njëjtën kohe.

Kompania jone ka kërkuar edhe Sqarime te Tenderit rreth kësaj çështje, ndërsa ne përgjigjen e Ministrisë se Shëndetësisë përkatësisht nga Zyrtari i Prokurimit ka pranuar qe është kundër-ligjore iniciimi i Procedurës dhe prape ka vazhduar me procedurën e prokurimit.

Pra duke u bazuar ne faktet e lartpërmendura kërkojmë Rishqyrtim e vendimit te AK për iniciimin e procedurës se tenderimit.

### **Pergjigjia e Autoriteit Kontraktues ne lidhje me pretendimin Ankimore**

Ne lidhje me dispozitat e shkelura te LPP-se për te cilat pretendon "Sinorg Pharmaceuticals", Autoriteti Kontraktues hedhë poshtë te gjitha pretendimet e OE.

1. Neni 1 (Qëllimi) – sipas këtij neni AK është i obliguar qe të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë. Edhe pse nuk keni dhënë asnjë argument se si është shkelur kjo dispozite, AK ju njofton se ka publikuar Njoftimin për kontratë duke shfrytëzuar procedurën e hapur me qëllim te sigurimit ne mënyrën me efikase me transparente dhe me te drejte te shfrytëzimit et fondeve publike.
2. Neni 6 (Ekonomiciteti dhe Efikasiteti) - sipas këtij neni AK është i obliguar qe te siguroj që fondet publike dhe burimet publike përdoren në mënyrën më ekonomike, gjë te cilën AK e ka respektuar, duke iniciuar aktivitetn e prokuirmit përmes procedurës se hapur dhe ne te njëjtën kohe thekson se nuk keni dhënë asnjë argument se si është shkelur kjo dispozite.
3. Neni 7 (Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi) - sipas këtij neni AK është i obliguar qe do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese, gjë te cilën AK e ka respektuar, sepse ka shpallur aktivitetin duke përdorur procedurën e haur dhe ne te njëjtën kohe thekson se nuk keni dhënë asnjë argument se si është shkelur kjo dispozite.
4. Neni 56 (Dispozitat e Pergjithshme mbi Perzgjedhjen e Pjesemarrësve dhe Dhenien e Kontratave) – ky nen percakton dispozitat e perzgjedhjes se OE te cilat duhet te percaktohen ne Dosje te Tenderit dhe ne te njejen kohe percakton se gjate vlerimit asnje tenderues, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. AK thekson se te gjitha kërkesat e përcaktuara ne DT janë ne përputhje me dispozitat e LPP-se dhe ne përputhje me "Ligjin për produkte dhe pajisje Meridionale" dhe gjithashtu ju informon se edhe për ketë nen nuk keni dhënë asnjë argument është shkelur kjo dispozite.

Ne lidhje me inicimin e dy procedurave dhe mos lejimi i inicimit te dy procedurave te njëjta te prokurimit ne te njëjtën kohe MSh edhe njëherë ju sqaron se nuk lejohet ne rrethana te rregullta, POR ne rastin konkret, meqenëse lënda është kontestuar nga MSh dhe rasti është ne Gjyrate, ne mënyre qe te sigurohet furnizimi me barna për te burgosurit, është iniciuar procedura për një periudhe 6 mujore deri ne zgjidhje te kontestit.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

**Vendimi i Operatoreve dorëzohet:**

1. Sinorg Pharmaceuticals
2. Operatoret ekonomik te interesuar



Berat Marmullaku

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit